

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 Dhjetor 2024
AKTIVET		
I. Aktivet Afatshkurtra		
Mjete monetare	4	164,102,070
Të drejta të arkëtueshme	5	11,274,681
Inventarët	6	578,383
Totali i aktiveve afatshkurtra		175,955,134
II. Aktivet afatgjata		
Aktive materiale	7	10,324,787
Aktive jo-materiale	8	875,474
Totali i aktiveve afatgjata		11,200,261
TOTALI I AKTIVEVE		187,155,395
DETYRIMET		
I. Detyrimet afatshkurtra		
Detyrime tregtare	9	1,050,913
Të pagueshme për detyrime tatimore	10	30,305,116
Të tjera detyrime afatshkurtra	11	12,548,341
Provizione		
Totali I detyrimeve afatshkurtra		43,904,370
II. Detyrime afatgjata		
Grante	12	1,163,912
Totali i detyrimeve afatgjata		1,163,912
Totali I Detyrimeve		45,068,282
III. Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nënshkruar	13	20,000,000
Fitim i vitit	13	122,087,113
Totali I Kapitalit		142,087,113
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		187,155,395

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 janë hartuar me datë 14.02.2025 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Arlinda Pogaj

Administratador



Eduina Avdulaj

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Shef i Sektorit të Financës

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Shënime	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	270,793,516
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	138,648
Shpenzime të personelit	16	
1. Paga dhe shpërblime		(104,886,258)
2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(14,159,976)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7-8	(800,682)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	17	(7,400,907)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		143,684,341
Të ardhura të tjera		
Shpenzime financiare	18	
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(41,579)
Fitimi (humbja) para tatimit		143,642,762
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	
1. Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës		(21,555,649)
Fitimi (humbja) neto e vitit		122,087,113
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		
Totali i të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin		122,087,113



Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO

	Kapitali i nënshkruar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar deklaruar më 28 Shkurt 2024	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit		122,087,113	122,087,113
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	20,000,000		
Dividendë të paguar			
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike			
Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2024	20,000,000	122,087,113	142,087,113



Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

(metoda indirekte)

Për vitin e mbyllur më
31 Dhjetor 2024

I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	
Fitim/ Humbja e periudhës	122,087,113
Rregullime për shpenzimet jomonetare:	
Shpenzime konsumi & amortizimi	800,682
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	
Rënie / (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(11,274,680)
Rënie / (rritje) në inventare	(578,383)
Rritje / (renie) në detyrimet e pagueshme	1,050,913
Rritje / (renie) në detyrimet e tjera	42,853,457
Mjete monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	154,939,102
II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit	
a. Para të përdorura për blerjen e filialeve (shuma neto)	
b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve (shuma neto)	
c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(12,000,943)
Mjete monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit	(12,000,943)
III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit	
a. Arketime nga emetimi i kapitalit	20,000,000
b. Arketime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral	
c. Hua të arkëtuara	
d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	
e. Riblereje e aksioneve të veta	
f. Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral	
g. Pagesa e huave	1,163,912
Mjete monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit	21,163,912
IV. Rritja/(pakësimi) neto i mjeteve monetare	164,102,070
V. Mjetet monetare në fillim të periudhës	-
VI. Mjetet monetare në fund të periudhës	164,102,070



Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" Sh.a (në vijim referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 01.03.2024 si Shoqëri aksionare. Shoqëria është e regjistruar në Degën e Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT/NUIS M41501042N.

Shoqëria zhvillon aktivitet në fushën e kryerjes së procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive, Institucioneve të varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës.

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 20,000,000 lekë dhe është i ndarë në 20,000 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili.

Aksionet e shoqërisë, janë të zakonshme dhe regjistrohen në regjistrin e aksioneve.

Shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Këshilli mbikqyrës i shoqërisë në 31 dhjetor 2024 përbëhet nga:

- | | |
|------------------|--------|
| 1- Sokol Ismaili | anëtar |
| 2- Lira Pipa | anëtar |
| 3- Edmond Ahmeti | anëtar |
| 4- Elinda Pupla | anëtar |
| 5- Anisa Pollo | anëtar |

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është znj. Arlinda Pogaj.

Adresa e shoqërisë është: Rruga "Reshit Çollaku", Godina Nr. 6/337, Tiranë

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 është 78 punonjës.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019 "Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre", rezultojnë që shoqëria Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, klasifikohet si shoqëri me interes publik për shkak të natyrës së biznesit

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, klasifikohen, shoqëritë ku shteti ka pjesëmarrje në kapital.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri.

Vijueshmëria

Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregtar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare, dhe se nuk pret të ketë shmangie kundrejt shumave të buxhetuara për vitin 2025. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2024 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

2.2 BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.



2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shqipërisë.

2.4 VLERËSIME DHE GJYKIME

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi. Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 TRANSAKSIONET NË MONEDHË TË HUAJ

Transaksionet në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datën e këmbimit, të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është percaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	2024
Kursi në fund të vitit Euro/Lekë	98.15
Kursi mesatar Euro/Lekë	100.71

3.2 INSTRUMENTA FINANCIAR

Instrumentat financiar jo-derivative përbëhen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, si dhe llogari të pagueshme dhe të tjera.

Instrumentat financiar jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parave së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare

Mjete monetare përfshijnë tepricat e parave në llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat e pakufizuara me maturitetin tre muaj ose më pak nga data e krijimit. Shoqëria, më 31 dhjetor 2024 nuk ka asnjë depozitë.



Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 INSTRUMENTA FINANCIAR (VAZHDIM)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit.

Ne rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kane jetë gjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit duke filluar nga dita e blerjes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Kategoria e aktivit	Metoda e Amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike dhe pajisje	Lineare	20%
Pajisje zyre	Lineare	20%
Pajisje informatike	Lineare	25%
Aktive jo materiale	Lineare	15%

3.4 ZHVLERËSIMI

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 ZHVLERËSIMI (VAZHDIM)

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Per aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërise, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 PROVIZIONET

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat njihen në pasqyrën e performancës në përputhje me SKK 8 “Të ardhurat”. Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

3.7 SHPENZIME PËR PERSONELIN

Gjatë aktivitetit të saj normal, Shoqëria kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet e sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized cursive letters.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit, shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit dhe interesat.

3.9 QIRATË

Qiratë mund të klasifikohen si qira financiare ose qira të zakonshme. Kontrata(t) e qirasë për zyrat e Shoqërise klasifikohen si qira e zakonshme dhe Shoqëria nuk ka qira financiare. Pagesat e qirasë së zakonshme njihen si shpenzime, duke përdorur metodën lineare përgjatë afatit të qirasë me që nëse kontrata e qirasë është me cmim fiks mujor.

3.10 TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Mjete monetare ALL	164,102,070
Totali	164,102,070

5. TË DREJTA TË ARKËTUESHME

Të drejtat e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Kërkesa të arkëtueshme	11,274,681
Totali	11,274,681

6. INVENTARËT

Inventarët më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Inventarët	578,383
Totali	578,383



7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive afatgjata materiale të Shoqërise më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Totali	Mobilje pajisje zyre	Pajisje informative	Te tjera aktive afatgjata
Me 31 Dhjetor 2023	-	-	-	-
Shtesa	11,108,443	3,442,943	7,584,833	80,667
Pakesime	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2024	11,108,443	3,442,943	7,584,833	80,667
Amortizim Akumuluar	I			
Me 31 Dhjetor 2023	-	-	-	-
Shtesa	(783,656)	(147,073)	(628,842)	(7,741)
Pakesime	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2024	(783,656)	(147,073)	(628,842)	(7,741)
Vlera Kontabel Neto				
Me 31 Dhjetor 2023	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2024	10,324,787	3,295,870	6,955,991	72,926

8. AKTIVE AFATGJATA JO MATERIALE

Aktive afatgjata jomateriale të Shoqërise më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Totali	Koncensione dhe të drejta të ngjashme, licensa
Me 31 Dhjetor 2023	-	-
Shtesa	892,500	892,500
Me 31 Dhjetor 2024	892,500	892,500
Amortizim I Akumuluar		
Me 31 Dhjetor 2023	-	-
Shtesa	(17,026)	(17,026)
Me 31 Dhjetor 2024	(17,026)	(17,026)
Vlera Kontabël Neto		
Me 31 Dhjetor 2023	-	-
Me 31 Dhjetor 2024	875,474	875,474



9. DETYRIME TREGTARE

Detyrimet tregtare më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,050,913
Totali	1,050,913

10. TË PAGUESHME PËR DETYRIME TATIMORE

Të pagueshme për detyrime tatimore më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Detyrim për Sigurimet Shoqërore & Shendetsore	3,887,475
Detyrim për Tatimin mbi të Ardhurat	2,575,615
TVSH e pagueshme	2,240,491
Detyrim për Tatimin në burim	45,886
Tatimi mbi fitimin	21,555,649
Totali	30,305,116

11 TË TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA

Të tjera detyrime afatshkurtra më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Depozite garanci	12,288,318
Debitore të tjere ,kreditore të tjere	260,023
Totali	12,548,341

12 DETYRIME AFATGJATA

Detyrimet afatgjata më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Grante	1,163,912
Totali	1,163,912

Gjatë vitit 2024, bazuar në dokumentacionin e detajuar më poshtë, shoqëria përfituar aktive afatgjata materiale, për të cilat ka njohur dhe vlerësuar me vlerën e drejtë të aktiveve të përfituara zërin "Grante", të paraqitura si detyrime afatgjata.

-Sipas urdhërit nr.133 datë 05.08.2024 midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është marrë vendimi për transferimin e inventarit ekonomik të Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara tek shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara" Sh.a, si kalim kapitali pa pagesë. Vlera e aktiveve sipas dokumentacionit është vlerësuar në shumën prej 262,786 Lekë.

-Sipas urdhërit nr.540 datë 23.07.2024 nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është marrë vendim për transferimin e pajisjeve kompjuterike nga Insituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore tek shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara" Sh.a si kalim kapitali pa pagese. Vlera e aktiveve sipas dokumentacionit është vlerësuar në shumën prej 1,036,390 lekë.



13 KAPITALI DHE REZERVAT

Kapitali i vet më 31 Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024
Kapitali aksioner	20,000,000
Fitimi i vitit	122,087,113
Totali I Kapitalit	142,087,113

14 TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Te ardhurat nga shitja e shërbimeve	270,793,516
Totali	270,793,516

15 TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	138,648
Totali	138,648

16 SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Pagat	(104,886,258)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	(14,159,976)
Totali	(119,046,234)



17 SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI

Shpenzimet të tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Të konsumueshme të tjera	(339,248)
Shërbim i ruajtjes fizike	(1,266,130)
Qira	(1,052,362)
Shpenzime honorare KD	(3,692,249)
Shërbime mirëmbajtjeje	(90,000)
Shërbim hostimi, domain	(21,143)
Shpenzime kancelarie	(532,758)
Shpenzime Komunikimi	(273,878)
Taksa dhe tarifa të tjera	(12,500)
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-
Gjoha dhe dëmshpërblime	(1,945)
Shpenzime të tjera	(118,694)
Totali	(7,400,907)

18 SHPENZIME FINANCIARE, NETO

Të ardhurat / shpenzimet financiare, neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Të ardhura financiare:	
<i>Të ardhura nga interesat</i>	-
<i>Të ardhura nga kurset e këmbimit</i>	-
	-
Shpenzime financiare:	
<i>Shpenzime Interesi</i>	-
<i>Komisione bankare</i>	(41,579)
<i>Shpenzime nga kurset e këmbimit</i>	-
	(41,579)
Totali	(41,579)



19 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për biznesin e madh për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024. Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Për periudhën nga 1 Mars deri 31 Dhjetor 2024
Fitimi Kontabël	143,642,762
Shpenzime të panjohura sipas ligjit fiskal	
Shpenzime të tjera	59,620
Gjoka dhe penalitete	1,945
Shpenzime të pritjes e përfaqësimit	-
Totali i shpenzimeve të panjohura	61,565
Fitimi i tatueshëm	143,704,327
Humbje e mbartur	
<i>Tatimi mbi fitimin @ 15%</i>	21,555,649
Parapagime gjatë vitit	
Tatim fitimi kreditor	(21,555,649)

20 ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore. Vecanërisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme përsa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Në rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Shoqëria është në proces gjyqësor për disa çështje ligjore, një pjesë e të cilave janë të mbartura për procedurat e zhvilluara nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe pjesa tjetër janë zhvilluar nga shoqëria Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

21 NGJARJE TË MËPASHME

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

